Vendim nr. 285, datë 31.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 31.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (I) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:	**INDRIT KODRA**
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1891 (230), datë 14.05.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.** **Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 4, 18, 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka filluar marrëdhënien e punës në datën 28.09.2009 pranë shoqërisë "Tirana International Airport" sh.p.k. *(TIA)*, me detyrën e specialistit të menaxhimit të mjedisit.

Këtë detyrë ai e ka kryer deri në datën 05.05.2016, datë kur është ndërprerë marrëdhënia e punës me të, ndërsa marrëdhënia financiare është ndërprerë në muajin gusht, për shkak të afatit të njoftimit. Marrëdhënia e punës mes palëve është rregulluar nga kontrata e punës së datës 28.09.2009, si dhe aneksi i kontratës i datës 01.07.2015.

2. Me shkresën ref. RCV/SK, datë 21.03.2016, pala e paditur ka iniciuar procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës me kërkuesin, duke e njoftuar këtë të fundit që të paraqitej në datën 29.03.2016 në takimin sqarues në lidhje me kontratën e punës dhe vendimin që do të merrte TIA në lidhje me këtë kontratë, takim ky që nuk rezulton të jetë zhvilluar, si dhe nuk ka pasur vendimmarrje në lidhje me ecurinë e marrëdhënies së punës mes palëve. Me shkresën ref. RCV/SK datë 22.04.2016, është njoftuar përsëri kërkuesi për takimin që do të zhvillohej në datën 29.04.2016, ora 11:00, në ambientet e TIA-s, për të biseduar për kontratën e punës dhe vendimin që do të merrej në lidhje me këtë kontratë. Rezulton se ky takim është zhvilluar në datën 29.04.2016, siç rezulton nga procesverbali i mbajtur në takim, dhe TIA i ka bërë me dije kërkuesit vendimin e saj për zgjidhjen e kontratës së punës, e cila do të ishte efektive pas kalimit të afatit tremujor të njoftimit, ndërkohë që për atë periudhë ka vijuar pagesën e tij pa e zënë me punë.

3. Punëdhënësi TIA, më 05.05.2016, ka zgjidhur kontratën e punës mbështetur në nenet 141, 143/1 dhe 144 të Kodit të Punës, duke ia komunikuar atij me shkresën nr. 203, datë 05.05.2016. Kërkuesi, duke mos qenë dakord, ka paraqitur kërkesëpadi ndaj TIA-s duke kërkuar detyrimin e saj për ta dëmshpërblyer në masën e pagës së një viti për zgjidhje të menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së punës, bazuar në nenin 155, paragrafi 3, të Kodit të Punës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10086, datë 13.12.2016, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e TIA-s t'i paguajë kërkuesit dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së punës me pagën e një viti pune. Kundër vendimit ka paraqitur ankim TIA.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1348, datë 19.05.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10086, datë 13.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Mbi rekursin e TIA-s, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2025-1891 (230), datë 14.05.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10086, datë 13.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. 1348 datë 19.05.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit.

6. Në datën 30.04.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata),* sipas objektit të tij. Në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e mbrojtjes*, pasi Gjykata e Lartë i ka dërguar njoftim efektiv TIA-s për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore, gjë që nuk e ka bërë në rastin e tij.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe sigurinë juridike,* pasi Gjykata e Lartë, përmes një arsyetimi kontradiktor për ligjin e zbatueshëm procedural të kohës, pa dëgjuar palët në seancë dhe me 3 gjyqtarë, ka vendosur jashtë kompetencave të dhëna nga ligji ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Ligji i kohës parashikonte seancë plenare dëgjimore, çka nuk është realizuar nga Gjykata e Lartë, duke zbehur garancitë procedurale mbrojtëse të tij.

7.2. *E drejta për punë e lidhur me standardin e arsyetimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë ka paraqitur një arsyetim të paqartë lidhur me afatin e njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sipas nenit 143, pika 3, të Kodit të Punës, duke e konsideruar ndërprerjen si jo të menjëhershme në ndryshim nga gjykatat e faktit. Gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar si zgjidhje me afat të menjëhershëm, pasi nuk është respektuar afati i përcaktuar në nenin 143 të Kodit të Punës, ndërsa apeli ka vlerësuar se neni 143 i Kodit të Punës gjen zbatim në gjendjen që ishte para ndryshimit me ligjin nr. 136/2015, pasi afati kishte filluar para hyrjes së tij në fuqi, ndaj duhej zbatuar ligji siç ishte para ndryshimeve. Në rastin konkret interpretimi i Gjykatës së Lartë është dukshëm i paarsyeshëm në interpretimin e fjalisë *"Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës zgjatet sipas rastit deri në fund të javës ose në fund të muajit."*, pasi termi *"sipas rastit"* do të duhej të interpretohej në favor të punëmarrësit, duke rezultuar në faktin se kur afati i njoftimit nuk mbaron në fund të javës ose muajit, ai *a priori* do të duhej të zgjatej pa u lidhur me vullnetin e palëve për këtë zgjatje, siç interpretohet nga ajo gjykatë.

7.3. *E drejta e pronës e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj i është referuar vetëm afatit të njoftimit, pa analizuar shkakun e zgjidhjes së kontratës. Interpretimi i dispozitave të Kodit të Punës nga Kolegji Civil, edhe nëpërmjet vendimit unifikues nr. 19/2007 të Gjykatës së Lartë, në favor të punëdhënësve krijon pabarazi mes këtyre të fundit dhe punëmarrësve, të cilëve iu dobësohen pozitat në rastet e zgjidhjes të kontratave të punës. Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta interpretuar normën në atë drejtim që rezultati të jetë i pajtueshëm me Kushtetutën. Po ashtu, ajo gjykatë ka zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, duke gabuar në zbatimin e legjislacionit procedural.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Për sa u takon kritereve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kritereve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes

për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

10. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e mbrojtjes, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe sigurinë juridike*. Kërkuesi, po ashtu, ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për punë dhe së drejtës së pronës të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

11. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën e mbrojtjes*, pasi Gjykata e Lartë i ka dërguar njoftim efektiv TIA-s për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore, gjë që nuk e ka bërë në rastin e tij.

12. Në rastin në shqyrtim, nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rubrika "*Çështje të shpallura për gjykim*", për kategorinë "*Çështje civile*", nënrubrika "*Për shqyrtim në dhomë këshillimi*", rezulton se në datën 29.04.2025 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 14.05.2025, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuesit.

13. Po kështu, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se nga ana e TIA-s është lënë adresa elektronike në aktet e dorëzuara nga ajo, sipas së cilës është njoftuar për seancën gjyqësore. Ndërkohë, adresa elektronike e kërkuesit rezulton të jetë lënë në Gjykatën e Lartë vetëm në datën 03.12.2025, pra pas dhënies së vendimit nga ajo gjykatë, me qëllim njoftimin e vendimit të arsyetuar. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vëren se në kushtet kur nga dokumentacioni në dosjen gjyqësore nuk konstatohet që nga kërkuesi të jenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit deri në momentin e gjykimit, palëve u është njoftuar, në mënyrën e parashikuar nga ligji, data, ora e seancës dhe përbërja e trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nga aktet e vëna në dispozicion rezulton se kërkuesi është njoftuar për rekursin e palës së paditur duke pasur të gjitha mundësitë të paraqiste kundërrekurs. Për sa më sipër, Kolegji çmon se ky pretendim i tij është haptazi i pabazuar.

14. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, përmes një arsyetimi kontradiktor për ligjin e zbatueshëm procedural të kohës, pa dëgjuar palët në seancë dhe me 3 gjyqtarë, ka vendosur, jashtë kompetencave të dhëna nga ligji, ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Ligji i kohës parashikonte seancë plenare dëgjimore, çka nuk është realizuar nga Gjykata e Lartë, duke zbehur garancitë procedurale mbrojtëse të tij.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj, pavarësisht karakterit civil ose penal të procesit, është shprehur se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale kalimtare (*shih vendimet nr. 19, datë 25.04.2013; nr. 11, datë 23.04.2009; nr. 11, datë 19.09.1995 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji Civil në vendimin e tij, për sa i takon ligjit të zbatueshëm procedural, ka arsyetuar se rekursi i TIA-s është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 18.07.2017, duke evidentuar edhe faktin se ndryshimet ligjore që ka pësuar KPC-ja me ligjin nr. 44/2021 kanë hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Sipas saj, në nenin 32 të ligjit nr. 44/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: "*Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre*.". Në rastin e rekurseve të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, siç është edhe rasti i kërkuesit, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre.

17. Për sa i takon pretendimit për ligjin procedural të zbatueshëm në gjykimin e çështjes së kërkuesit, Kolegji vëren se nga ana e Kolegjit Civil është arsyetuar mjaftueshëm, duke konkluduar se në rastin e kërkuesit do të zbatoheshin kriteret e pranueshmërisë së rekursit sipas nenit 472 të KPC-së së kohës së depozitimit të rekursit. Lidhur me këtë pretendim vlerësohet se referuar ligjit nr. 44/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", nenit 32, pika 2, të tij "Dispozitë kalimtare", parashikohet se rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Referuar këtij përcaktimi, dhe konkretisht togfjalëshit "*konsiderohen të pranueshme",* ligji i kohës aplikohet vetëm për shkaqet e pranueshmërisë së rekursit të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, ndërkohë që procedura lidhur me gjykimin dhe përbërjen e trupit gjykues u nënshtrohet përcaktimeve të KPC-së në kohën e gjykimit, kjo edhe sipas parimit *tempus regit processum.* Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

18. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me sigurinë juridike,* si dhe *së drejtës për punë* dhe *së drejtës së pronës të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.* Duke mbajtur parasysh thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vlerëson që këto pretendime t'i trajtojë në vijim në kuadër të standardit të arsyetimit gjyqësor, i cili bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

19. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka paraqitur një arsyetim të paqartë lidhur me afatin e njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas nenit 143, pika 3, të Kodit të Punës, duke e konsideruar atë si ndërprerje jo të menjëhershme në ndryshim nga gjykatat e faktit. Gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar si zgjidhje me afat të menjëhershëm, pasi nuk është respektuar afati i përcaktuar në nenin 143 të Kodit të Punës, ndërsa apeli ka vlerësuar se neni 143 i Kodit të Punës gjen zbatim në gjendjen që ishte para ndryshimit me ligjin nr. 136/2015, pasi afati kishte filluar para hyrjes së tij në fuqi, ndaj duhej zbatuar ligji siç ishte para ndryshimeve. Në rastin konkret interpretimi i Gjykatës së Lartë është dukshëm i paarsyeshëm në interpretimin e fjalisë *"Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës zgjatet sipas rastit deri në fund të javës ose në fund të muajit."* pasi termi *"sipas rastit"*, do të duhej të interpretohej në favor të punëmarrësit, duke rezultuar në faktin se kur afati i njoftimit nuk mbaron në fund të javës ose muajit, ai *a priori* do të duhej të zgjatej pa u lidhur me vullnetin e palëve për këtë zgjatje, siç interpretohet nga ajo gjykatë.

20. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj i është referuar vetëm afatit të njoftimit, pa analizuar shkakun e zgjidhjes së kontratës. Interpretimi i dispozitave të Kodit të Punës nga Kolegji Civil, edhe nëpërmjet vendimit unifikues nr. 19/2007, në favor të punëdhënësve krijon pabarazi mes këtyre të fundit dhe punëmarrësve, të cilëve iu dobësohen pozitat në rastet e zgjidhjes të kontratave të punës. Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta interpretuar normën në atë drejtim që rezultati të jetë i pajtueshëm me Kushtetutën. Po ashtu, ajo gjykatë ka zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, duke gabuar në zbatimin e legjislacionit procedural.

21. Gjykata ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë argumentet e kërkuesit, Kolegji do të verifikojë nëse arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë ka përmbushur funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsyetimit të vendimit.

23. Në çështjen në shqyrtim, dy gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrimin që kërkesëpadia e kërkuesit ishte e drejtë dhe për rrjedhojë duhej pranuar si e bazuar në ligj dhe në prova, duke e konsideruar procedurën e zgjidhjes së kontratës si zgjidhje të menjëhershme në shkelje të nenit 153 të Kodit të Punës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit duke vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe duke rrëzuar përfundimisht padinë e kërkuesit.

24. Për sa i takon bazueshmërisë së pretendimeve, ai Kolegj ka evidentuar se pala e paditur (TIA), në cilësinë e punëdhënësit, i ka paguar paditësit, në cilësinë e punëmarrësit, pagën që ai do të duhet të merrte gjatë afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të Kodit të Punës, por nuk e ka zënë me punë gjatë kësaj periudhe. Ai kolegj ka vlerësuar se në rastin e kërkuesit gjendeshin para zgjidhjes normale të marrëdhënies së punës dhe jo para zgjidhjes së menjëhershme sipas nenit 153 të Kodit të Punës dhe kushteve të përcaktuar në të dhe se TIA kishte respektuar afatin e njoftimit ligjor, provuar kjo me faktin që marrëdhënia e punës së kërkuesit me palën e paditur ka përfunduar në datën 05.05.2016, ndërsa marrëdhëniet financiare kanë përfunduar në muajin gusht të vitit 2016, pas rreth 3 muajsh nga ndërprerja e marrëdhënies së punës. Kolegji Civil mbi këto fakte ka çmuar se afati i njoftimit quhet i respektuar, për sa kohë që punëdhënësi ka paguar pagën përkatëse të përfitueshme për periudhën e njoftimit për kërkuesin, pa qenë i detyruar ta zërë me punë atë gjatë kësaj periudhe, duke qenë se ofrimi i shërbimit ose realizimi i punës është detyrim për punëmarrësin dhe e drejtë e punëdhënësit dhe jo anasjelltas. Ndërkohë, sipas Kolegjit Civil, e drejta themelore e punëmarrësit në kontratën e punës është të marrë pagën gjatë kohëzgjatjes së saj, sipas nenit 129 të Kodit të Punës.

25. Kolegji Civil, gjithashtu, e ka konsideruar situatën e kërkuesit në përputhje me vendimin njësues nr. 724/2023, duke vlerësuar se afati i njoftimit do të konsiderohej i respektuar në qoftë se nga momenti i njoftimit të punëmarrësit deri në momentin e ndërprerjes financiare të marrëdhënies së punës ishte plotësuar afati ligjor ose kontraktor i njoftimit, pavarësisht faktit se punëdhënësi, në përputhje me të drejtën e tij, nuk e ka zënë me punë punëmarrësin gjatë kësaj periudhe. Sipas atij kolegji, i gabuar është edhe interpretimi i gjykatës së apelit që afati duhej të zgjatej deri në fund të muajit, pasi në interpretim të dispozitës dhe të termit të përdorur nga ligjvënësi "*sipas rastit*", duhet kuptuar që afati i njoftimit mund të zgjatet respektivisht deri në fund të muajit ose deri në fund të javës, në ato raste kur vetë palët me vullnetin e tyre kanë parashikuar në kontratën individuale ose kolektive të punës mundësinë e zgjatjes së këtij afati, ose kur punëdhënësi për të garantuar pozitën e punëmarrësit vendos me vullnetin e tij që të zgjasë këtë afat përtej datës përkatëse kalendarike me të cilën afati

korrespondon. Në këtë kuptim, Kolegji Civil ka arsyetuar se neni 143, pika 3, i Kodit të Punës nuk duhet kuptuar sikur vendos një detyrim kategorik për punëmarrësin për të shtyrë ose zgjatur afatin e njoftimit në çdo rast deri në fund të muajit, kur ky afat është i llogaritur në muaj dhe deri në fund të javës, kur ai është llogaritur në javë.

26. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Kolegji konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, brenda kompetencave të tij, ka shqyrtuar çështje të interpretimit të ligjit dhe konkretisht interpretimin e ligjit material, të neneve 143 dhe 129 të Kodit të Punës. Në këtë këndvështrim, Kolegji Civil ka arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktin nëse zgjidhja e kontratës së punës së kërkuesit do të konsiderohej si zgjidhje e menjëhershme ose si zgjidhje normale, duke respektuar afatin e njoftimit. Konkluzioni i Kolegjit Civil është bazuar edhe në përfundimet e vendimit njësues nr. 724/2023 të Gjykatës së Lartë, për sa kohë që është vërtetuar nëpërmjet shkresës nr. 203, datë 05.05.2016 të TIA-s se kontrata do të konsiderohej e zgjidhur në datën 05.08.2016, ndërkohë që ka vijuar pagesa mujore e rrogës. Po ashtu, Kolegji Civil ka konsideruar jo të drejtë edhe arsyetimin e gjykatës së apelit lidhur me zgjatjen e afatit të njoftimit deri në fund të javës ose muajit, sipas rastit, ndërkohë që thelbi i arsyetimit të bërë nga ai kolegji përbën çështje të interpretimit të ligjit dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

27. Si konkluzion, Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

28. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.